

S' ka ekzistuar kurrë asgjë? 1
Diçka 4
Kush 8
Kush2 12

S' ka ekzistuar kurrë asgjë?

Një udhëtim mendimi në fillimin e kohërave, origjinën e gjithësisë & çështjen e projektimit inteligjent...

A keni menduar ndonjëherë për **fillimin**? Çfarë është kjo, thoni ju? Me në fjalë--çdo gjë që është shfaqur për herë të parë. Ose çfarëdo gjëje që ka qenë këtu, në momentin më të hershëm në kohë. A keni vrarë ndonjëherë mendjen për këtë gjë?

Prit pak, ju po thoni, a nuk është e mundur që në fillim të mos ketë patur asgjë? A nuk është e mundur që miliarda vite më parë, nuk ka patur asgjë? Sigurisht, kjo është një teori që duhet shqyrtuar. Pra, le ta shqyrtojmë--por si fillim përmes analogjisë.

Le të themi që keni një dhomë të madhe të zezë. Është krejtësisht e mbyllur dhe me përmasat e një fushe futbolli. Dhoma është përherë e kyçur, dhe nuk ka asnjë derë apo dritare dhe asnjë vrimë në muret e saj.

Brenda nuk ka ... asgjë. Absolutisht asgjë. As grimcën më të vogël. Asnjë pikë ajri. Asnjë fije pluhuri. Aspak dritë. Është me një kyç të vulosur. Më pas, çfarë ndodh?

Mirëpo le të themi se synimi juaj është të nxirrni diçka--çfarëdo gjëje--në dhomë. Por rregullat janë: ju nuk mund të përdorni asgjë që gjendet jashtë dhomës për të realizuar këtë gjë. Kështu që çfarë bëni?

Dhe ju mendoni, po sikur të krijohet një shkëndijë brenda dhomës? Atëherë dhoma do të ketë dritë në të, edhe për pak çaste. Kjo do të ishte *diçka*. Po, por *ju* jeni jashtë dhomës. Pra, kjo gjë nuk lejohet.

Por, ju thoni, po sikur të dërgoj diçka me anë të teleportës brenda në dhomë, ashtu si tek Star Trek? Sërish, kjo nuk është e lejueshme, sepse do të përdorje gjëra nga jashtë dhomës. Këtu gjendet sërish

dilema: ju duhet të futni diçka në dhomë duke përdorur vetëm çfarë gjendet në dhomë. Dhe, në këtë rast, në dhomë nuk gjendet asgjë.

Mirëpo, ju thoni, ndoshta një grimcë e vogël do të shfaqet brenda dhomës nëse do të lihet kohë e mjaftueshme.

Ka tri probleme më këtë teori. E para, *koha* në vetvete nuk *bën* asgjë. Gjërat ndodhin me kalimin e kohës, por nuk është koha që i bën ato të ndodhin. Për shembull, nëse prisni 15 minuta për pjekjen e biskotave, nuk janë 15 minutat që i pjekin ato, është nxehtësia e furrës. Nëse i vendos mbi banak për 15 minuta, ato nuk do të piquen.

Në analogjinë tonë, kemi dhomë krejtësisht të mbyllur me asgjë brenda saj. Duke pritur 15 minuta, kjo nuk do ta ndryshojë situatën, në vetvete ose nga vetvetja. Por ju thoni, po sikur të presim me mijëra vjet? Me këtë kuptojmë segmente prej 15 minutash të ngjeshura së bashku. Nëse ju prisni me mijëra vjet me biskotat mbi banak, a do t'i piquen ato këto mijëra vite?

Problemi i dytë është: *pse* do të "shfaqej" ndonjë gjë në një dhomë bosh? Do të duhej një arsye se përse erdhi në ekzistencë. Por brenda dhomës nuk ka gjë. Pra, çfarë do ta pengonte atë që të vazhdonte të mbetej ashtu? Nuk do të kishte asgjë brenda dhomës për të shkaktuar shfaqjen e diçkaje (dhe megjithatë arsyeja duhet të vijë nga brenda dhomës).

Mirë, thoni ju, po një grimcë e vogël e diçkaje? A nuk do të kishte një mundësi më të madhe për t'u materializuar në dhomë se diçka më e madhe, për shembull, një top futbolli?

Kjo nxjerr në pah problemin e tretë: madhësia. Ashtu si koha, madhësia është abstrakte. Është relative. Le të themi se kemi tri topa bejzbollit, me madhësi të ndryshme. Njëri është me diametër 2 metra, njëri 1 metër dhe një tjetër që është normal. Cili ka më shumë mundësi për t'u materializuar në dhomë?

Ai që është normal? Jo! Është e njëjta mundësi për të tri topat e bejzbollit. Madhësia nuk ka rëndësi. Nuk është kjo çështja. Çështja është nëse do të "shfaqej" apo jo *ndonjë* top bejzbollit i *çfarëdo* madhësie në dhomën tonë të kyçur dhe të vulosur.

Nëse nuk mendoni se topi më i vogël i bejzbollit thjesht mund të shfaqej në dhomë, pavarësisht sa kohë ka kaluar, atëherë duhet të arrini në përfundimin se është e njëjta gjë edhe për një atom. Madhësia nuk është problem. Mundësia e një grimce të vogël për t'u materializuar pa një shkak nuk është ndryshe nga ajo e një frigoriferi që të materializohet pa shkak!

Tani, le ta zgjerojmë analogjinë tonë, në kuptimin e plotë të fjalës. Le ta marrim dhomën tonë të zezë e të mbyllur dhe t'i heqim muret, dhe ta zgjerojmë dhomën, aq sa të shkojë në infinit në të gjitha drejtimet. Tani, nuk ka asgjë jashtë dhomës, sepse dhoma është e gjitha ç'ka ekziston. Pikë.

Kjo dhomë e zezë në infinit nuk ka dritë, pluhur, asnjë grimcë të ndonjë lloji, as ajër, asnjë element, asnjë molekulë. Është asgjëja absolute. Në fakt, mund ta quajmë **Absolutisht Asgjë**.

Prandaj, shtrohet pyetja: nëse fillimisht--miliarda vjet më parë--kishte Absolutisht Asgjë, a nuk do të kishte Absolutisht Asgjë edhe tani?

Po. Sepse diçka--pavarësisht sa e vogël--nuk mund të vijë nga Absolutisht Asgjë. Ne ende do të kishim Absolutisht Asgjë.

Çfarë na thotë kjo? Që kurrë nuk ka ekzistuar Absolutisht Asgjëja. Pse? Sepse, po qe se Absolutisht Asgjëja do të kishte ekzistuar, ende do të kishim Absolutisht Asgjë!

Nëse Absolutisht Asgjëja do të kishte ekzistuar, nuk do të kishte asgjë jashtë saj që të shkaktonte ekzistencën e diçkaje.

Edhe një herë, nëse Absolutisht Asgjë do kishte ekzistuar *ndonjëherë*, ende do të kishte Absolutisht Asgjë.

Sidoqoftë, diçka ekziston. Në fakt, shumë gjëra ekzistojnë. Ju, për shembull, jeni diçka që ekziston, një diçka shumë e rëndësishme. Prandaj, ju jeni prova se Absolutisht Asgjëja nuk ka ekzistuar kurrë.

Tani, nëse Absolutisht Asgjëja nuk ka ekzistuar kurrë, kjo do të thotë se ka patur gjithnjë një kohë kur të paktën ka qenë Diçka në ekzistencë. Çfarë ishte ajo?

A ishte një gjë apo shumë gjëra? A ishte një atom? Një grimcë? Një molekulë? Një top bejzbolli mutant? Një frigorifer? Disa biskota?

Për ta zbuluar, shkoni tek ([Diçka](#).)

Diçka

Shënim: Ky artikull pason artikullin me titull [Asgjë](#)

Nëse ka patur ndonjëherë Absolutisht Asgjë, ende do të kishte Absolutisht Asgjë edhe sot. Duke qenë se ka diçka (ju, për shembull), kjo do të thotë se Absolutisht Asgjëja nuk ka ekzistuar kurrë. Nëse ka ekzistuar ndonjëherë, ju nuk do të ishit këtu duke lexuar në këto çaste. Absolutisht Asgjëja do të ishte këtu.

Pra, nuk ka patur kurrë një kohë kur Absolutisht Asgjëja të ketë ekzistuar. Prandaj, *ka qenë gjithnjë* diçka. Por çfarë? Nëse i kthehemi fillimit, çfarë ishte Diçkaja që duhet të ketë ekzistuar? A ishte më shumë se një Diçka apo thjesht një? Dhe si dukej, duke u bazuar në atë çfarë ekziston sot?

Le të eksplorojmë çështjen e sasisë të parën. Le të sjellim në mendje dhomën tonë të madhe, të zezë dhe të vulosur. Përfytyroni sikur ka dhjetë topa tenisi brenda dhomës. Për aq sa mund të kthehemi mbrapa në kohë, kemi vetëm këtë gjë: dhjetë topa tenisi.

Çfarë ndodh më pas? Le të themi se presim një vit të tërë. Çfarë ka në dhomë? Ende vetëm dhjetë topa tenisi, apo jo? Sepse nuk ka forcë tjetër në ekzistencë, dhe e dimë dhjetë topa të zakonshëm tenisi--nuk ka rëndësi sa kohë kalon--nuk mund të pjellin topa të tjerë apo ndonjë gjë tjetër.

Dakord, po sikur të kishte gjashtë topa tenisi në dhomë si fillim? A do ta ndryshonte kjo situatën? Jo, aspak. Mirë atëherë, po sikur të kishte një milion topa tenisi? Ende asnjë ndryshim. Gjithçka që kemi futur në dhomë janë topat e tenisit, pavarësisht sa shumë janë.

Ajo që zbulojmë është se sasia nuk është problemi. Nëse i kthehemi fillimit të të gjitha gjërave, sasia e Diçkaje që duhet të ketë ekzistuar nuk është ajo çfarë ka rëndësi. Apo jo?

Hiqini topat e tenisit. Tani brenda dhomës gjendet një zog pule. Ne presim një vit. Çfarë gjendet brenda dhomës? Thjesht vetëm një zog pule, apo jo? Por, po sikur të fillojmë me një pulë dhe një gjel në dhomë? Tani presim një vit, çfarë kemi? Shumë më tepër zogj pule!

Pra sasia është e rëndësishme, NËSE brenda dhomës gjenden të paktën dy gjëra të cilat mund të prodhojnë një gjë të tretë. Pulë + gjel = zog pule. Por sasia nuk ka rëndësi nëse flasim për të paktën dy gjëra të cilat *nuk mund* të prodhojnë një gjë të tretë. Top tenisi + top futbollit = asgjë.

Pra çështja nuk është aq sasia sesa cilësia. Çfarë cilësish zotëron Diçkaja? A mund të sjellë gjëra të tjera në ekzistencë?

Le t'u kthehemi zogjve tanë të pulës, por le të jemi shumë të saktë, pasi e tillë do të ishte çështja qysh në fillim. Kemi një pulë dhe një gjel në dhomë. Ata janë në pjesë të ndryshme të dhomës, të mënjanuar në asgjënë. A do të pjellin zogj të tjerë?

Jo. Pse? Sepse nuk ka asnjë mjedis ku të punojnë. Nuk ka asgjë në dhomë përveç pulës dhe gjelit. Nuk ka ajër për të marrë frymë apo për të fluturuar, nuk ka dysheme ku të ecin, nuk ka mjete jetese me të cilat mund të jetojnë. Ata nuk mund të hanë, të ecin, të fluturojnë apo të marrin frymë. Mjedisi i tyre është asgjë e plotë.

Pra shpendët përjashtohen. Shpendët nuk mund të ekzistojnë ose të riprodhohen pa asnjë lloj mjedisi. Me një mjedis, ata mund të pjellin shpendë të tjerë, dhe me një mjedis që i ndikon ata, ndoshta ata mund--megjithëse duket absurde--të ndryshojnë në një lloj tjetër shpendi me kalimin e kohës. Diçka në rrugën për t'u bërë kastor apo gjirafe.

Pra kemi një dhomë pa një mjedis. Prandaj, na duhet Diçka që mund të ekzistojë pa një mjedis. Diçka që nuk ka nevojë për ajër, ushqim, apo ujë për të ekzistuar. Kjo skualifikon çdo gjallesë të momentit mbi tokë.

Po për gjërat jo-të gjalla, ç'mund të thuhet? Ata nuk kanë nevojë për një mjedis, kjo është e vërtetë. Por gjendemi në të njëtin telash si me topat e tenisit. Gjërat jo të gjalla nuk prodhojnë ndonjë gjë. Le të themi, në vend të dhjetë topave të tenisit, ju keni tre miliardë molekula hidrogjeni. Atëherë çfarë ndodh? Me kalimin e kohës, ju ende keni tre miliardë molekula hidrogjeni, asgjë më shumë.

Ndërsa flasim për jogjallesat, le të shqyrtojmë gjithashtu se çfarë duhet që ato të ekzistojnë. Keni dëgjuar ndonjëherë për Superpërplasësin? Vite më parë qeveria kreu një eksperiment për të krijuar materien. Superpërplasësi ishte një tunel i nëndheshëm me kilometra e kilometra përmes të cilit atomet do të udhëtonin me shpejtësinë e zërit dhe më pas do të ndesheshin me njëri-tjetrin, me qëllim që të krijonin një grimcë të vogël. E gjithë kjo për pjesën më të vogël, mikroskopike të materies.

Çfarë na tregon kjo gjë? Se ilustrimi ynë i dhjetë topave të tenisit nuk është aq i thjeshtë sa duket. Do të duhej një sasi e MAHNITËSHME energjie thjesht për të prodhuar një top tenisi nga asgjëja. Dhe asgjëja është ajo çfarë kemi. Dhoma nuk ka asgjë në të.

Këtu gjendemi. Diçkaja që ekzistoi në fillim duhet të jetë në gjendje të ekzistojë pa u varur mbi diçka tjetër. Duhet të jetë tërësisht dhe plotësisht e vetëmjaftueshme. Sepse Ajo ishte e vetme që nga fillimi dhe Ajo nuk kishte nevojë për asnjë mjedis brenda të cilës të ekzistonte.

Së dyti, Diçkaja që ekzistonte që në fillim, duhet të ketë aftësinë të prodhojë diçka ndryshe nga Vetja. Sepse, nëse nuk do të mundej, atëherë ajo Diçka do të ishte gjithçka që do të ekzistonte sot. Por Diçka Tjetër ekziston sot. Ju, për shembull.

Së treti, të prodhosh Diçka Tjetër--nga asgjëja--kërkon një sasi të pamatshme fuqie. Kështu, Diçkaja duhet të ketë fuqi të madhe në dispozicion të vet. Nëse na kërkohet kilometra e kilometra korridor dhe energjia më e madhe që mund të ushtrojmë, thjesht për të prodhuar grimcën më të vogël, sa fuqi do të duhet për të prodhuar materien në univers?

Le t'i kthehemi dhomës sonë. Le të themi se kemi një top tenisi të veçantë brenda dhomës. Ai *mund* mund të prodhojë topa të tjerë

tenisi. E ka këtë fuqi dhe energji të madhe. Dhe Ai është plotësisht i vetë-mjaftueshëm, duke mos patur nevojë për asgjë tjetër që të ekzistojë, sepse Ai është gjithçka ekziston. Ai, ky top i vetëm tenisi, është Diçkaja e Përjetshme.

Le të themi se topi i tenisit prodhon një tjetër top tenisi. Cili nga këta dy topa do të jetë më i madh në lidhje me KOHËN? Topi #1. Është Diçkaja e Përjetshme. Gjithnjë ka ekzistuar. Megjithatë Topi #2 erdhi në ekzistencë kur u prodhua nga Topi #1. Kështu, një top është finit përse i përket kohës, tjetër është infinit.

Cili nga dy do të jetë më i madh në lidhje me FUQINË? Sërish, Topi #1. Ai ka aftësinë për të prodhuar Topin #2 nga asgjëja--që do të thotë gjithashtu se ka aftësinë për të shkatërruar Topin #2. Kështu Topi #1 ka më shumë fuqi se Topi #2. Në fakt, gjatë gjithë kohës, Topit #2 i duhet të varet nga Topi #1 për vetë ekzistencën e tij.

Por, ju thoni, po sikur Topi #1 të ndajë paksa nga fuqia e tij me Topin #2--fuqi të mjaftueshme për të shkatërruar Topin #1? Atëherë Topi #2 do të ishte më i madh, sepse Topi #1 do të ndalonte të ekzistonte, apo jo?

Ka një problem këtu. Nëse Topi #1 ndan paksa nga fuqia e tij me Topin #2, ende kemi të bëjmë me fuqinë e Topit #1. Atëherë shtrohet pyetja: a do të mund ta përdorte Topi #1 fuqinë e tij për të shkatërruar veten? Jo. Para së gjithash, për të përdorur fuqinë e tij, Topi #1 duhet të ekzistojë.

Së dyti, Topi #1 është kaq i fuqishëm, aq sa çdo gjë ka mundësi të mund të bëhet, mund të bëhet nga Topi #1. Por nuk është e mundur që Topi #1 të pushojë së ekzistuari, prandaj, ai nuk mund ta realizojë këtë gjë.

Topi #1 nuk mund të shkatërrohet, sepse Topi #1 nuk u prodhua nga diçka tjetër. Topi #1 gjithnjë ka ekzistuar. Është Diçkaja e Përjetshme. Si i tillë, është vetë ekzistenca. Është vetë jeta, jeta infinite. Që të shkatërrohet Topi #1, duhet të ekzistojë diçka më e madhe. Por asgjë nuk është më e madhe se Topi #1, as nuk do të mund të jetë. Ai ekziston pa i patur nevojën asgjëje tjetër. Prandaj, nuk mund të ndryshohet nga ndonjë forcë e jashtme. Nuk mund të ketë asnjë fund, sepse nuk Ai nuk ka asnjë fillim. Është ashtu siç është dhe nuk mund

të ndryshojë. Nuk mund të pushojë së ekzistuari, sepse TË QENIT është vetë natyra e tij. Në këtë kuptim, është i paprekshëm.

Ajo çfarë ne shohim është kjo: Diçkaja e fillimit fare do të jetë gjithnjë më e madhe sesa Diçkaja Tjetër që ajo prodhon. Diçkaja ekziston në vetvete. Diçkaja Tjetër ka nevojë për Diçkanë që të ekzistojë. Prandaj, Diçkaja Tjetër ka nevoja. Është më inferiore ndaj Diçkasë, dhe kështu do të jetë gjithnjë, sepse Diçkaja e Përjetshme nuk ka nevojën e një tjetre.

Diçkaja mund të jetë në gjendje të prodhojë Diçka Tjetër që është *njëlloj* si Ajo në disa aspekte, por--pavarësisht se çfarë--Diçkaja Tjetër do të jetë gjithnjë *ndryshe* nga Ajo në disa aspekte. Diçkaja e Përjetshme do të jetë gjithnjë më e madhe në lidhje me kohën dhe fuqinë. Kështu, Diçkaja e Përjetshme nuk mund të prodhojë një diçka ekzaktësisht të barabartë me Vetën. Vetëm ajo ka ekzistuar gjithnjë. Vetëm ajo mund të ekzistojë e pavarur nga diçka tjetër.

A dëshironi të eksploroni më shumë për Diçkanë e Përjetshme? Shihni [Kush](#).

Kush

Shënim: ky artikull pason artikullin me titull [Diçka](#)

Ekziston një Diçka e Përjetshme. Diçka ka ekzistuar gjithnjë. Diçka nuk ka fillim. Në qoftë se kjo Diçka ka ndonjë nevojë, Ajo mund t'i përmbushë ato nevoja për Vetën. Nuk ka nevojë për asgjë tjetër që të ekzistojë. Dhe Ajo nuk mund të prodhojë një të barabartë ekzakte apo një tjetër që është më e madhe. Çdo gjë që prodhohet nuk është e përjetshme. Prandaj, Diçkaja e Përjetshme nuk mund të prodhojë Diçka të Përjetshme. Do të jetë gjithnjë më e madhe se çdo gjë tjetër që ekziston.

Tani, a mund të ishte shumë kjo Diçka e Përjetshme. Le të themi se fillimisht kishte pesë Diçka të Përjetshme. Megjithatë, nëse do të ishte kështu, këto të pesta do të ishin ekzaktësisht të njëjta përsa i përket kohës dhe fuqisë. Të gjitha të paprodhuara, të gjitha të përjetshme, të

gjitha të afta të bëjnë çfarëdo që është e mundur për t'u bërë. Sërish, kjo na tregon se cilësia, jo sasia, është në të vërtetë çështja.

Pra, çfarë dimë për Diçkanë (Diçkatë) e Përjetshme? Nuk është e vetme, sepse Diçka Tjetër ekziston. Ju, për shembull. Tani, mund të pyesni veten, a jeni ju Diçkaja e Përjetshme, apo një nga Diçkatë e Përjetshme? Nëse jeni ju, atëherë ju nuk keni asnjë fillim, asnjë nevojë të cilën ju vetë të mos e përmbushni, dhe çdo gjë që ka mundësi të bëhet, mund të bëhet nga ju. A jeni ky ju? Nëse jo, atëherë jeni me të vërtetë Diçka Tjetër, jo Diçkaja e Përjetshme apo një nga Diçkatë e Përjetshme.

Le t'i kthehemi dhomës sonë të madhe, të zezë dhe të zbrazët. Le të themi se një molekulë hidrogjeni dhe një molekulë azoti janë në dhomë. Për hir të argumentit, le të themi se këto janë Diçkatë e Përjetshme. Ato kanë ekzistuar gjithnjë. Çdo gjë mund të bëhet, Ato mund ta bëjnë.

Kështu, Ato vendosin të prodhojnë Diçkanë Tjetër, sepse Ato janë gjërat e vetme që ekzistojnë në dhomë. Por prit, a mund të *vendosin* ndonjë gjë hidrogjeni apo azoti? Mirë pra, që Ato të jenë Diçkaja e Përjetshme, Ato DUHET të kenë aftësinë për të marrë një vendim.

Mendo për këtë. Diçkaja e Përjetshme duhet të *zgjedhë* të ndryshojë gjërat. Diçkaja e Përjetshme është e përjetshme. Ajo ka ekzistuar gjithnjë e pavarur nga diçka tjetër. Çka është më e rëndësishmja, *vetëm* Ajo ka ekzistuar gjithnjë. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se asnjë ngjarje nuk mund të ndodhë pa pohimin e Diçkasë së Përjetshme.

Diçkaja e Përjetshme është gjithçka ekziston, pikë. Prandaj, e vetmja gjë në ekzistencë që mund të ndryshojë vetminë e Diçkasë së Përjetshme është Vetë Diçkaja e Përjetshme. Nuk mund të ketë asnjë forcë të jashtme jashtë Diçkasë së Përjetshme, sepse Diçkaja e Përjetshme është gjithçka që ekziston.

Prandaj, nëse një molekulë hidrogjeni dhe një molekulë azoti janë Diçkatë e Përjetshme, asnjë forcë e jashtme nuk mund t'i drejtojë Ato. Ato janë gjithçka që ekziston. Ato janë e *vetmja* forcë që ekziston.

Si të vetmet forca në ekzistencë, janë vetëm Ato të cilat mund të ndryshojnë vetminë e Tyre. Nuk ka asgjë në ekzistencë që arbitrarisht, rastësisht, mund t'i ndikojë Ato për të prodhuar Diçka Tjetër.

Diçkaja Tjetër nuk mund të prodhohet rastësisht. Pse? Sepse, që të ndodhë, "rastësia" duhet të ketë fuqi mbi molekulat e hidrogjenit dhe azotit. Por, Ato janë gjithçka ekziston. Çdo gjë që mund të bëhet, Ato mund ta bëjnë. "Rastësia" është Diçka Tjetër. Diçkaja Tjetër nuk mund të ketë fuqi mbi Diçkanë e Përjetshme. Në fakt, në këtë fazë, Rastësia as nuk ekziston.

Nëse Rastësia është diçka jashtë Diçkasë së Përjetshme, atëherë ajo nuk ekziston nëse nuk prodhohet nga Diçkaja e Përjetshme. Por edhe sikur Rastësia të prodhohet nga Diçkaja e Përjetshme, duke qenë se është Diçka Tjetër, do të jetë gjithnjë inferiore ndaj Diçkasë së Përjetshme.

Pra, nëse Diçkaja Tjetër prodhohet, prodhohet nëpërmjet fuqisë dhe VULLNETIT të Diçkasë së Përjetshme. Diçkaja Tjetër mund të prodhohet nga Rastësia vetëm nëse Rastësia është prodhuar përpara kësaj Diçkaje Tjetër. Por Rastësia vetë nuk mund të prodhohet rastësisht. Duhet të prodhohet nga vullneti i Diçkasë së Përjetshme.

Çfarë na tregon kjo për molekulat e hidrogjenit dhe azotit? Se Ato nuk janë thjesht Diçka Përjetshme, Ato janë Persona të Përjetshëm. Kjo do të thotë se Ato duhet të kenë aftësinë për të zgjedhur. Prandaj, Ato janë personale.

Sërisht, pse duhet të ketë Diçkaja e Përjetshme aftësinë për të zgjedhur? Mendoni përsëri për dhomën e zbrazët vetëm me molekulat e hidrogjenit dhe azotit në të. Ato janë Diçkatë e Përjetshme. Vetëm ato ekzistojnë në dhomë dhe kanë ekzistuar përjetësisht.

Ato ekzistojnë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Për mbijetesë, Ato nuk kanë nevojë për njëra-tjetrën. Prandaj, nëse Ato prodhojnë Diçka Tjetër, nuk ka të bëjë me nevojën (si një instinkt për mbijetesë sikurse e shohim tek kafshët). Gjithashtu, nëse Ato prodhojnë Diçka Tjetër, nuk do të jetë rastësisht--nëse nuk kanë prodhuar më parë Rastësinë. Rastësia është një forcë, por Diçkatë e Përjetshme (dy molekulat) janë e vetmja forcë që ekziston.

Për më tepër, molekulat nuk mund të jenë thjesht makina. Makineritë ndërtohen dhe programohen nga një forcë e jashtme e ndonjë lloji. Por molekulat (Diçkatë e Përjetshme) janë e vetmja forcë që ekziston. Asnjë forcë nuk ekziston jashtë Tyre.

Prandaj, nëse Ato prodhojnë Diçka Tjetër brenda dhomës, arsyeja për këtë prodhim duhet të qëndrojë brenda Tyre, sepse asnjë forcë tjetër nuk ekziston. Asgjë tjetër nuk ekziston brenda dhomës përveç Tyre.

Ato nuk detyrohen të prodhojnë Diçka Tjetër me anë të instinktit, rastësisë, nevojës, apo vullnetit të ndonjë tjetri. Ato nuk kontrollohen nga ndonjë tjetër. Çfarëdo gjëje që të bëjnë, bëhet për arsye brenda Vetes së Tyre.

Kjo arsye mund të jetë vetëm vullneti i Tyre. Ato duhet të zgjedhin të prodhojnë Diçka Tjetër, ose asgjë tjetër nuk do të ekzistojë. Ato do të mbeten vetëm përgjithnjë në dhomë, nëse Ato nuk vendosin të prodhojnë Diçka Tjetër. Ato duhet të kenë më shumë sesa fuqinë për të prodhuar Diçka Tjetër. Ato duhet -- në një moment i cili dallohet nga të gjitha momentet kur kanë ekzistuar vetëm -të vendosin të prodhojnë Diçka Tjetër.

Nëse nuk kanë aspak vullnet (sikurse topat e tenisit për të cilat folëm në një studim të mësipërm), atëherë fuqia e Tyre nuk do të përdoret kurrë për të prodhuar Diçka Tjetër. Fuqia e tyre do të përdorej vetëm për të çuar më tej ekzistencën e Tyre, dhe do të mbeteshin në vetmi përgjithnjë.

Diçkaja e Përjetshme ka ekzistuar e vetme përjetësisht. Prandaj, duhet të ketë një arsye brenda Diçkasë së Përjetshme, që ajo të ndryshojë. Nëse Diçka Tjetër ekziston, ajo ekziston për shkak të Diçkasë së Përjetshme, sepse Diçkaja e Përjetshme ka *zgjedhur* t'i japë fund vetmisë së saj.

Nëse arsyeja për Diçka Tjetër nuk gjendet brenda Diçkasë së Përjetshme, atëherë Diçkaja Tjetër nuk do të ekzistojë kurrë. Sepse Diçkaja e Përjetshme, në një farë pike, ishte gjithçka që ekzistoi.

Por ne e dimë se Diçka Tjetër ekziston. Prandaj, Diçkaja e Përjetshme duhet të ketë aftësinë të vendosë për të përdorur fuqinë e Saj. Duhet të ketë aftësinë të zgjedhë për të prodhuar Diçka Tjetër nga Vetvetja.

Duke qenë se [ka një vullnet](#), Diçkaja e Përjetshme është personale. Kjo do të thotë se Diçkaja e Përjetshme është në të vërtetë një Dikush i Përjetshëm.

Ky Dikush i Përjetshëm nuk kontrollohet nga instikti për mbijetesë, sepse Ai nuk ka nevoja dhe nuk mund të pushojë së ekzistuari sidoqoftë. Gjithashtu, Dikushi i Përjetshëm nuk prodhon nga Rastësia, nëse Ai së pari nuk prodhon Rastësinë. Rastësia është një forcë që duhet të prodhohet nga Diçkaja e Përjetshme, ose ajo nuk do të ekzistojë. Së fundi, Dikushi i Përjetshëm nuk është një makinë. Nuk ekziston asnjë tjetër, jashtë Vetes së Tij, që ta detyrojë Atë apo ta programojë të bëjë ndonjë gjë.

Për të vazhduar këtë studim, shihni [Kush 2](#).

Kush2

Vini re: ky artikull pason artikullin [Kush](#)

Ky është artikulli i fundit në një seri që filloi me [Asgjë](#), vazhdoi me [Diçka](#), pastaj me [Kush](#). Pikat kryesore që trajtojnë këto studime janë:

(1) Absolutisht Asgjëja nuk ka ekzistuar kurrë. Po të ishte kështu, ende do të kishte Absolutisht Asgjë. Por ekziston Diçka Tjetër, psh ju.

(2) Meqë Absolutisht Asgjë nuk ka ekzistuar kurrë, gjithmonë ka patur një kohë kur diçka ka ekzistuar. Këtë diçka mund ta quajmë Diçkaja e Përjetshme. Diçkaja e Përjetshme nuk ka as fillim, as fund, s'ka nevoja që nuk mund t'i plotësojë vetë, mund të bëjë çdo gjë që mund të bëhet dhe do të jetë gjithmonë superior ndaj çdo gjëje që ajo sjell në ekzistencë.

(3) Diçkaja e Përjetshme nuk është makinë, e kontrolluar apo e programuar nga ndonjë forcë jashtë vetes. Dhe Diçkaja e Përjetshme nuk sjell gjëra në ekzistencë nga nevoja, sepse Ajo nuk ka nevoja. Prandaj, nëse Ajo sjell në ekzistencë Diçka Tjetër, vendos të bëjë kështu. Kjo do të thotë se Diçkaja e Përjetshme ka një vullnet; pra është personale. Prandaj, Diçkaja e Përjetshme duhet të jetë në të vërtetë Dikush (ose më shumë se një Dikush) i Përjetshëm.

Duke vazhduar, çfarë mund të kuptojmë tjetër për Dikushin e Përjetshëm, përtej asaj që është thënë deri tani? (Do t'i referohemi me Ai, por gjinia nuk po diskutohet këtu.)

Meqenëse Dikushi i Përjetshëm nuk ka nevoja që nuk mund t'i plotësojë Vetë, Ai mund të ekzistojë pa ndonjë lloj mjedisi, sepse Ai ekzistonte kur nuk kishte asgjë tjetër veç Tij. Çdo mjedis do të ishte jashtë Tij, dhe prandaj do të duhej të sillej në ekzistencë. Por gjithçka që ekziston është Ai.

Ka të ngjarë, pra, që Dikushi i Përjetshëm të jetë transcendent, që do të thotë se Ai mund të ekzistojë jashtë kohës dhe hapësirës, sepse Ai nuk kushtëzohet nga asnjëra. Ai ka ekzistuar përjetësisht, prandaj është jashtë kohës. Dhe Ai ekziston pa patur nevojë për ndonjë mjedis, duke qenë kështu jashtë hapësirës.

Duke qenë transcendent ndaj kohës dhe hapësirës, është e mundur që Dikushi i Përjetshëm të jetë i padukshëm. Vetëm diçka që zë hapësirë është e dukshme. Nëse diçka është jashtë hapësirës, si mund të shikohet? Kështu, Dikushi i Përjetshëm është e mundur të jetë i padukshëm dhe mund të ekzistojë pa patur nevojë për trup apo formë.

Për hir të diskutimit le të themi se Dikushi i Përjetshëm vendos të sjellë në ekzistencë Diçka Tjetër - ose më mirë, Dikë Tjetër. Dikushi i Përjetshëm zgjedh të sjellë në ekzistencë Dikë Tjetër që është si Ai në disa aspekte. Si Ai, Dikushi Tjetër do të ketë vetëdije, që është një aspekt i domosdoshëm i të paturit vullnet. Pra, Dikush Tjetër është një person dhe ka një vullnet.

Ç'mund të themi tjetër për këtë Dikë Tjetër? A do të jetë ai jashtë kohës? Jo, Dikush Tjetër nuk do të kishte ekzistuar përjetësisht. Dikushi Tjetër do të kishte një fillim dhe kështu do të ishte i kufizuar nga koha.

Mbani mend se çdo gjë që Dikushi i Përjetshëm sjell në ekzistencë do të jetë inferior në lidhje me Të në kohë dhe hapësirë. Kjo është e pashmangshme. Prandaj edhe nëse Dikushi Tjetër do të ekzistojë përgjithmonë në të ardhmen, ai ende do të kishte një fillim në kohë. Në të vërtetë, koha e tij do të binte brenda kohës [infinite] të Dikushit të Përjetshëm.

Po në lidhje me hapësirën? Do të ishte Dikushi Tjetër i kufizuar nga hapësira? Po. Vetëm Dikushi i Përjetshëm mund ekzistojë pa ndonjë lloj mjedisi. Dikushi Tjetër do të kishte nevojë për një mjedis në të cilin të ekzistojë, por çfarë? Mendoni për hapësirën si për kohën. Dikushi Tjetër ekziston brenda kohës së Dikushit të Përjetshëm. Në një mënyrë të ngjashme, Dikushi Tjetër do të ekzistojë brenda "hapësirës" së Dikushit të Përjetshëm.

Dikushi i Përjetshëm e tejkalon hapësirën. Kështu siç është kudo në kohë, Ai është kudo në hapësirë. Prandaj kur Dikush Tjetër sillet në ekzistencë, ai do të ekzistojë brenda kohës dhe hapësirës së Dikushit të Përjetshëm. Dikushi i Përjetshëm është mjedisi brenda të cilit Dikushi Tjetër do të ekzistojë! Pra, tani kemi Dikë Tjetër, dhe Dikushi i Përjetshëm ekziston rreth e rrotull tij. Por ka një problem. Ai nuk mund ta shohë Dikushin e Përjetshëm, sepse Dikushi i Përjetshëm e tejkalon hapësirën. Ai nuk zë një pjesë të hapësirës sepse Ai është gjithë hapësira. Për ta parë Atë duhet të shikosh gjithë kohën dhe hapësirën. E pamundur.

Pra Dikush Tjetër nuk mund ta dallojë Dikushin e Përjetshëm. Atëherë çfarë duhet të bëjë Dikushi i Përjetshëm do nëse Ai do të dallohet nga Dikush Tjetër? Ai duhet të "shfaqet." Njëfarë "kufizimi" në kohë dhe hapësirë është i domosdoshëm. Është e mundur kjo? Po.

Mbani mend, Dikushi i Përjetshëm mund të bëjë çdo gjë që mund të bëhet. Do të ishte e mundur për Të që ta bënte veten të dallueshëm nga Dikush Tjetër, domethënë të "shfaqej." Si?

Ne e dallojmë praninë e një tjetri në botën tonë nëpërmjet të parit, të nuhaturit, prekjes, shijimit, dëgjimit. Nëse Dikushi i Përjetshëm do t'i jepte Dikujt Tjetër aftësinë për të parë ose dëgjuar, për shembull, atëherë Dikushi i Përjetshëm mund (1) të shfaqej në një formë të dukshme, (2) t'i fliste Dikujt Tjetër, ose (3) t'i bënte të dyja. Këto do të ishin mënyra për t'u shfaqur në mënyrë që Dikushi i Përjetshëm të mund të dallohet nga Dikushi Tjetër.

Mbani mend, Dikush Tjetër është sjellë në ekzistencë. Kështu Dikushi Tjetër është i kufizuar nga koha dhe hapësira. Çfarëdo që të jetë struktura apo natyra e tij, ai do të jetë i dallueshëm në kohë dhe hapësirë. Prandaj, Dikushit të Përjetshëm i duhet vetëm të marrë

çfarëdo forme që i ka dhënë Dikushit Tjetër që të bëhet i dallueshëm për të.

Por ka një pyetje: nëse Dikushi i Përjetshëm "kufizohet" brenda hapësirës dhe kohës me qëllim që të dallohet, a është kjo gjithçka e Dikushit të Përjetshëm? Jo! Ai është më shumë sesa mund të bëjë të njohur. Megjithëse Ai mund të zbulojë shumë për Vetën, edhe të gjithë Vetën-domethënë Vetën në transcendencën e Tij - nuk mund të njihet apo kuptohet plotësisht nga Dikush Tjetër.

Për "koincidençë" skenari i përshkruar më sipër është saktësisht ai që shohim në Bibël. Ne jemi si Dikushi Tjetër. Ne jemi të kufizuar nga koha dhe hapësira. Perëndia është Dikushi i Përjetshëm. Dhe Ai shfaqet në personin e Jezu Krishtit. Për më tepër shikoni poshtë...

1. Perëndia është Dikushi i Përjetshëm. Ai ka ekzistuar dhe do të vazhdojë të ekzistojë gjithmonë. **(1)**
2. Perëndia është i padukshëm. **(2)**
3. Në një kuptim, ne ekzistojmë brenda Perëndisë sepse Perëndia është kudo, megjithatë Perëndia është i dallueshëm nga ne. **(3)**
4. Perëndia mund të bëjë çdo gjë që mund të bëhet. **(4)**
5. Është mundur që Perëndia të "kufizohet" në hapësirë dhe kohë. Ai mund ta zbulojë Vetën duke marrë formë njerëzore. **(5)**
6. Kur Perëndia shfaqet, ajo që shohim nuk është gjithçka e Tij, por prapë është Ai. **(6)**

Do të donit ta njihnit këtë Perëndi? Nëse po, [ja si...](#)

(1) *Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishe formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia.*

Psalmi 90:2

Nuk e di ti, vallë, nuk e ke dëgjuar? Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës, nuk mundohet dhe nuk lodhet, zgjuarësia e tij është e panjohshme.

Isaia 40:28

Kështu thotë Zoti, mbreti i Izraelit dhe çliruesi i tij, Zoti i ushtrive: "Unë jam i pari dhe jam i fundit, dhe përveç meje nuk ka Perëndi.

Isaia 44:6

Jezusi u tha atyre: "Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam.

Gjoni 8:58

Krishti është i njëjtë dje, sot e përjetë.

Hebrenjve 13:8

"Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi", thotë Zoti "që është dhe që ishte dhe që vjen, i Plotfuqishmi.

Zbulesa 1:8

(2) *Askush s'e pa Perëndinë kurrë; i vetëmlinduri Bir, që është në gjirin e t'Et, është ai që e ka bërë të njohur.*

Gjoni 1:18

Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet t'a adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën".

Gjoni 4:24

Dhe Mbretit të amshuar, të pavdekshmit, të padukshmit, të vetmit Perëndi të ditur, i qoftë nder e lavdi në shekuj të shekujve. Amen.

1 Timoteut 1:17

... që, në kohën e caktuar, do ta tregojë i lumi e i vetmi sundimtar, Mbreti i mbretërve dhe Zot i zotërve, ai që i vetmi e ka pavdekësinë dhe rri në dritë të paafrueshme, të cilën asnjë njeri nuk e ka parë kurrë dhe as mund ta shohë; atij i qoftë nderi dhe pushteti i përjetshëm. Amen.

1 Timoteut 6:15-16

(3) *Ku do të mund të shkoja larg Frymës sate, ose ku do të mund të ikja larg pranisë sate?*

Psalmi 139:7

Perëndia që bëri botën dhe të gjitha gjërat që janë në të, duke qenë Zot i qiellit dhe i tokës, nuk banon në tempuj të bërë nga duart e njeriut, dhe as shërbehet nga duart e njerëzve, sikur të kishte nevojë për ndonjë gjë, sepse ai u jep të gjithëve jetë, hukatje dhe çdo gjë; dhe ai ka bërë nga një gjak i vetëm të gjitha racat e njerëzve, që të

banojnë në mbarë faqen e dheut, dhe caktoi kohërat me radhë dhe caqet e banimit të tyre, që të kërkojnë Zotin, mbase mund ta gjejnë duke prekur, ndonëse ai nuk është larg nga secili prej nesh. Sepse në të ne jetojmë, lëvizim dhe jemi, sikurse kanë thënë edhe disa nga poetët tuaj: "Sepse jemi edhe ne pasardhës të tij".

Vep 17:24-28

(4) *A ka vallë diçka që është shumë e vështirë për Zotin?*

Zanafilla 18:14

Por Perëndia ynë është në qiejtë dhe bën tërë ato që i pëlqejnë.

Psalmi 115:3

[Unë] ... shpall fundin që në fillim, dhe shumë kohë më parë gjërat që ende nuk janë bërë, duke thënë: "Plani im do të realizohet dhe do të bëj gjithçka më pëlqen",

Isaia 46:10

Dhe Jezusi duke përqëndruar shikimin mbi ata tha: "Për njerëzit kjo është e pamundur, por për Perëndinë çdo gjë është e mundur".

Mateu 19:26

...sepse me Perëndinë asgjë s'është e pamundshme".

Luka 1:37

(5) *Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi.*

Gjoni 1:1

Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë.

Gjoni 1:14

Atë që ishte nga fillimi, atë që dëgjuam, atë që pamë me sytë tanë, atë që vështruam dhe që duart tona e prekën lidhur me Fjalën e jetës (dhe jeta u shfaq dhe ne e pamë e dëshmojmë për të, dhe ju shpallim jetën e përjetshme që ishte pranë Atit dhe që na u shfaq neve),

1 Gjoni 1:1-2

Ai është shëmbëllesa e Perëndisë së padukshëm, i parëlinduri i çdo krijese, sepse në të u krijuan të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato mbi dhe, gjërat që duken dhe ato që nuk duken: frone, zotërime, principata dhe pushtete; të gjitha gjërat janë krijuar me anë të tij dhe në lidhje me të.

Kol 1:15-16

Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies së tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij, mbasi e bëri vetë pastrimin nga mëkatet tona, u ul në të djathtën e Madhërisë në vendet e larta.

Hebrenjve 1:3

Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit.

Filipianëve 2:5-8

(6) *Ju keni dëgjuar që ju thashë: "Unë po shkoj dhe do të kthehem te ju". Po të më donit, do të gëzoheshit sepse unë thashë: "Po shkoj tek Ati"; sepse Ati është më i madh se unë.*

Gjoni 14:28

Jezusi i tha: "Ka kaç kohë që unë jam me ju dhe ti nuk më ke njohur akoma, o Filip? Kush më ka parë mua, ka parë Atin; Si vallë po thua: "Na e trego Atin?"

Gjoni 14:9

Unë dhe Ati jemi një".

Gjoni 10:30

© StudentiShqiptar.com

-- eksploro çështje në lidhje me jetën dhe Perëndinë --